



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Detyrimet kontingjente të ministrisë në PFV ishin të mbivlerësuara për 240,500€.
- B2 Obligimet e pa-paguara në PFV ishin të nënvlerësuara për 36,443€.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A1 Në katër (4) raste kishte menaxhim jo të mirë të procesit të pranimit të faturave dhe ekzekutimit të pagesave. Kjo kishte rezultuar me konteste gjyqësore dhe kosto shtesë për buxhetin e ministrisë.
- C1 Për dy projekte të përfunduara për parqet industriale në zona ekonomike në vlerë 2,366,512€, ministria nuk kishte kryer procedurat për bartje të pronësisë tek komunitetet përkatëse.
- A2 Kontrata “Renovimi i zyrave të KIESA” në vlerë 171,603€, nuk ishte realizuar sipas afatit të kontraktuar dhe ministria nuk ka ndërmarrë veprime për zgjatjen e afatit të kontratës dhe vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit.
- B3 Në tri (3) raste kemi vërejtur pozita të mbajtura të punës me zëvendësues përtej afateve të lejuara ligjore dhe jo në harmoni me legjislacionin në fuqi.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat me probleme më të theksuara kanë të bëjnë me raportim jo të drejtë të detyrimeve kontingjente dhe obligimeve të pa-paguara në Pasqyrat Financiare Vjetore.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, ministria duhet të forcojë kontrollet në pranimin dhe verifikimin e faturave, me qëllim shmangien e obligimeve të pabazuara, kontesteve gjyqësore dhe pagesave të dyfishta.

Po ashtu, janë identifikuar mangësi edhe në planifikimin dhe zbatimin e kontratave përfshirë edhe menaxhimin e kontratave përmes platformës e-prokurimi. Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre përtej afateve të lejuara ligjore mbetet edhe më tutje një çështje sfiduese për një menaxhim më efikas të aktiviteteve dhe arritjes së objektivave të ministrisë.

Në fushën e pasurive, përkundër progresit të konstatuar, mbetet ende çështja e bartjes së pronësisë së pasurive tek komunat përkatëse, pas përfundimit të procesit të investimit nga ministria. Për më tutje, nuk ishte bërë harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Raportim jo i saktë i detyrimeve kontingjente

**Gjetja** Rregullorja MF nr.01/2017, neni 18 obligon organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PFV. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen.

Ne identifikuam se detyrimet kontingjente në pasqyra ishin mbivlerësuar për 240,500€, si në vijim:

- Dy lëndë në vlerë 217,897€ nuk ishin larguar nga regjistri i detyrimeve kontingjente edhe pse procesi gjyqësor për këto lëndë kishte përfunduar me aktvendim të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale; dhe
- Në regjistër të detyrimeve kontingjente, është përfshirë gabimisht edhe një lëndë në vlerë prej 22,603€, e cila ka të bëjë me një padi të iniciuar nga ministria ndaj një pale tjetër dhe si e tillë ajo paraqet pasuri kontingjente, dhe jo detyrim kontingjent, siç është paraqitur.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mungesës së komunikimit dhe informatave jo të përditësuara nga departamenti ligjor, i cili ka pasur ndryshime të shpeshta në menaxhim. Po ashtu, kishte edhe mungesë të komunikimit me Avokaturën Shtetërore si përfaqësuese e ministrisë në procedurat gjyqësore.

**Ndikimi** Mos raportimi i saktë ka ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontingjente në PFV-të e vitit 2025.

**Rekomandimi B1** Ministrja, duhet të siguroj kontrolle dhe mekanizma efektiv të komunikimit ndërmjet departamentit ligjor, të financave dhe Avokaturës Shtetërore, me qëllim të sigurimit të informatave të përditësuara lidhur me statusin dhe përmbajtjen e lëndëve gjyqësore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Nënvlërësim i obligimeve të pa-paguara në PFV**

**Gjetja** Neni 17.3 i Rregullores MF nr.01/2017 për Raportim Financiar Vjetor përcakton: Organizata Buxhetore duhet t'i raportojnë të gjitha detyrimet për vitin raportues.

Dy marrëveshje bashkëfinancimi të nënshkruara më 18.12.2025 nga skema e granteve në sektorin e industrive kreative ndërmjet KIESA-s dhe dy përfituesve në vlerë 20,000€ dhe 16,443€ nuk janë paraqitur si obligime në PFV për vitin 2025. Megjithatë, pagesat për këto marrëveshje janë realizuar në fillim të vitit 2026, si shlyerje e këtyre obligimeve.

Arsyeja e mos raportimit të obligimeve në PVF ishte si rezultat i mangësive në kontrolle dhe mos komunikimit të duhur në mes departamenteve.

**Ndikimi** Mos prezantimi i obligimeve të papaguara ka ndikuar në nënvlerësim të obligimeve dhe rrjedhimisht në prezantimin jo të saktë të tyre në PFV.

**Rekomandimi B2** Ministrja duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një koordinim më efektiv në mes departamenteve në raportimin e obligimeve me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve të papaguara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Dobësi në pranimin e faturave dhe ekzekutimin e pagesave

**Gjetja** Rregullorja Financiare Nr 01/2013 - përkatësisht neni 24 përcakton se të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit; 1.1 Të sigurohet që fatura nuk është paguar më parë; 1.2. Të siguroj raportin e pranimit të mallit /shërbimit nga zyrtari / komisioni i autorizuar; 1.3 Fatura të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave.

Ne identifikuam mangësi në pranimin e faturave dhe procesimin e pagesave si në vijim:

- Për kontratën “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm Drenas”, MINT përmes menaxherit të kontratës, me datë 09.12.2025 kishte pranuar dhe protokoluar faturën në vlerë 170,284€ për situacionin IV të punimeve pa raport të pranimit të punëve (fatura ishte raportuar si obligim i papaguar në PFV). Për më tutje, për këtë kontratë MINT më 13.10.2025 kishte pranuar një vendim nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit që kërkonte anulimin të kësaj kontrate. Kontrata nuk ishte anuluar pasi MINT kishte ushtruar padi në gjykatë për vendosjen e masës së sigurisë dhe pezullimin e vendimit. Kërkesa e ministrisë për pezullim të ekzekutimit të këtij vendimi (vendosje e masës së sigurisë), ishte refuzuar edhe nga Gjykata Themelore dhe e Apelit. Kontesti në lidhje me këtë kontratë ende vazhdon deri sa ne ishim në auditim (prill 2026).
- Për kontratën “Ndërtimi i infrastrukturës në parkun industrial Opterushë”, MINT në muajin mars kishte pranuar një faturë prej 28,057€ pa raport të pranimit të punëve nga menaxheri i kontratës dhe kjo faturë ishte prezantuar si obligim në PFV për vitin 2025. Në qershor të vitit 2025 MINT kishte shkëputur njëanshëm kontratën me Operatorin Ekonomik. Në raportin përfundimtar të përpiluar nga MINT për të konstatuar gjendjen lidhur me punët e kryera dhe pagesat e realizuara (përfshirë edhe penalet që ka aplikuar MINT për vonesa) ka rezultuar se OE i ka borgj MINT-it 14,049€. Për këtë kontratë OE kishte bërë padi në gjykatë dhe kemi një kontest të hapur.
- Kontesti gjyqësor për faturën që ndërlidhet me kontratën "Ndërtimi i infrastrukturës në parkun industrial në Budrigë", në vlerë 112,226€ ishte humbur nga ana e MINT si rezultat i menaxhimit jo të mirë të procesit të pranimit të faturave. Siç është elaboruar edhe në raportin e auditimit të vitit paraprak kontesti i mospagesës së faturës nga MINT ishte kërkesa që OE të ndryshoj datën e faturës pasi që pranimi i punëve ishte bërë nga komisioni pesë muaj pas pranimit të kësaj fature. Për ekzekutim të pagesës, operatorit ekonomik i është kërkuar të anuloj faturën fillestare dhe ta lëshoj një faturë të re vetëm me ndryshim të datës së faturës. OE kishte refuzuar anulimin e faturës fillestare me arsyetimin se i ka deklaruar librat e shitjes në ATK dhe ka iniciuar procedurë gjyqësore për arkëtim të borgjtit. Si pasojë, në mars të vitit 2025 ishte ekzekutuar pagesa përmes vendimit gjyqësor e kësaj fature në vlerë 130,177€, pra duke paguar

shpenzime shtesë të interesit dhe gjykatës në vlerë 17,951€.

- Për kontratën “Vetura me qira”, përmes urdhrimit përmbartimor Ministria kishte ekzekutuar pagesën e një fature në vlerë 706€ (përfshirë shpenzimet e interesit). E njejtat faturë ishte ekzekutuar më pas edhe nga Thesari. Ministria kishte njoftuar Thesarin për këtë rast, por ende nuk ishin ndërmarrë masa për kthim të mjeteve nga operatori ekonomik.

Kjo situatë është rezultat i mungesës së kontrolleve efektive në procesin e pranimit të faturave. Pranimi dhe protokolimi të faturave pa dokumentacion mbështetës, dhe mungesa e komunikimit të duhur në mes departamenteve po shkakton konteste të vazhdueshme gjyqësore.

#### Ndikimi

Këto mangësi kanë rezultuar në kosto shtesë për buxhetin e Ministrisë, konteste në proces si dhe rritje të mundësisë potenciale për konteste të reja gjyqësore me OE.

#### Rekomandimi A1

Ministrja duhet të forcojë kontrollet e brendshme duke siguruar që çdo faturë të pranohet dhe procedohet vetëm pas pranimit formal të punëve dhe dokumentimit përkatës, të shmangë njohjen e obligimeve të pabazuara, si dhe të ndërmarrë masa për rikthimin e mjeteve të paguara gabimisht dy herë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja C1 - Mos bartja e pasurisë jo financiare kapitale të Komunitatit përkatës

#### Gjetja

Rregullorja MF-nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në nenin 13 përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistrojë në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj".

Udhëzimi administrativ MF - nr.04/2019 për definimin e projekteve kapitale dhe klasifikimin e shpenzimeve të projekteve kapitale, përkatësisht pika 3 e Neni 8, ndër të tjera përcakton se shpenzimet në fazën e zbatimit të projektit (faza e projektimit, planifikimit dhe prokurimit), klasifikohen si shpenzime kapitale.

Në dy raste MINT nuk kishte bartur pasurinë tek Komunitatit përkatës pas përfundimit të investimeve, dhe këto raste përfshijnë:

- Projekti “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Shirokë” ka përfunduar në shtator të vitit 2021 por pronësia nuk është bartur në Komunitatit të Suharekës ashtu siç është praktikuar me projektet tjera të investuara në parqet industriale. Për më tutje, ky investim figuron si aset në përdorim i ministrisë, në vlerë neto prej 2,357,162€. Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit në mes Ministrisë dhe Komunitatit, marrëdhëniet pronësore juridike për këtë projekt janë përgjegjësi e komunitatit si dhe përfitimet nga qiratë e bizneseve i arkëton komuna;

dhe

- Nga projekti “Ndërtimi i infrastrukturës në Parkun Industrial në Budrikë” kishte mbetur pa u bartur te Komuna përkatëse pagesa në vlerë 9,350€ për revidimin e projektit kryesor për parkun e biznesit në Budrikë. Kjo figuronte ende si investim në vijim në regjistrin e ministrisë nga viti 2018.

Mos-bartja e pronësisë ka ndodhur në mungesë të kontrolleve të brendshme, si dhe për shkak të paqartësisë lidhur me transferimin e pronësisë së investimeve.

**Ndikimi** Kjo situatë krijon paqartësi në menaxhimin dhe kontrollin e aseteve si dhe raportimin e tyre në regjistra të pasurisë.

**Rekomandimi C1** Ministria duhet të sigurojë që për projektet të cilat janë të përfunduara dhe janë bërë pranimet teknike, të bëhet bartja e pronësisë tek Komunitatet përkatëse. Gjithashtu, marrëveshjet e ardhshme për projekte investive duhet të përfshijnë dispozita të qarta për trajtimin e pronësisë dhe kapitalizimit të investimeve, për ti evituar paqartësitë në këtë fushë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Mangësi në planifikim dhe menaxhim të kontratës**

**Gjetja** Neni 70.23 i Rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik përcakton: Menaxheri i kontratës do të menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë si dhe të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë.

MINT ka nënshkruar kontratën “Renovimi i zyreve të KIESA” më datë 17.10.2025, në vlerë 171,603€. Sipas kushteve të veçanta të kontratës, kohëzgjatja për përmbushjen e punimeve është përcaktuar maksimumi 60 ditë kalendarike nga lëshimi i urdhërit për fillimin e punimeve nga menaxheri i kontratës.

Urdhëri për fillimin e punimeve nuk ishte lëshuar nga ministria edhe pse kishte kaluar një periudhë 5 mujore nga nënshkrimi i kontratës. Operatori Ekonomik, pas nënshkrimit të kontratës kishte shprehur gatishmëri për fillimin e punimeve dhe i ishte drejtuar dy herë Autoritetit Kontraktues për marrjen e urdhëresës së punës. Megjithatë, AK nuk kishte krijuar kushtet për fillimin e zbatimit të kontratës, me arsyetimin se nuk ishte bërë zgjidhje për zhvendosjen e personelit nga hapësirat që do të renovohen.

Përkundër këtyre rrethanave, deri në përfundim të auditimit tonë (mars 2026), ministria nuk kishte ndërmarr masa për amendamentim të kontratës për zgjatje të afatit. Po ashtu, siguria e ekzekutimit kishte skaduar në janar të vitit 2026, pa u ndërmarrë masa për vazhdimin e vlefshmërisë së saj.

Mosfillimi i punës së kontraktuar, është rezultat i planifikimit të dobët dhe dështimit të AK për krijimin e parakushteve të nevojshme për zbatimin e kontratës.

**Ndikimi**

Mos-fillimi i punimeve sipas kontratës dhe skadimi i sigurisë së ekzekutimit rrisin rrezikun financiar për AK-në, pasi nuk ka mbrojtje në rast mosrealizimi të kontratës, si dhe rrezikun ligjor për konteste të mundshme ose kërkesa kompensimi nga OE.

**Rekomandimi A2**

Ministrja përmes menaxherit të kontratës duhet të sigurojë krijimin e kushtet e nevojshme për fillim të punëve. Po ashtu, të bëhet amendamenti i kontratës për zgjatje të afatit dhe të sigurohet vazhdimësia e sigurisë së ekzekutimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B3 - Mbajtja e pozitave të punës me ushtrues detyre/zëvendësues**

**Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 9, paragrafi 4 përcaktonë se pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve.

Nga të dhënat e pranuar nga departamenti i burimeve njerëzore, MINT mbante 29 pozita me vendime për ushtrues detyre/zëvendësim.

Ne identifikiuam se në tri raste, zyrtarët ishin duke e ushtruar pozitën si zëvendësues për një periudhë më të gjatë se dy (2) vite. Pozitat me zëvendësues ishin duke u mbajtur për një periudhë prej 30-36 muaj.

Për më tepër, vendimet për caktim si zëvendësues për zyrtarët në fjalë, janë marrë në vitin 2023 mbi bazën e një legjislacioni tashmë të shfuqizuar si dhe nuk ishin bërë harmonizimet me kornizën e re ligjore, përkatësisht me Ligjin për zyrtar publik (Ligjin bazik 08/L-197 dhe Ligjin 08/L-294 për ndryshime dhe plotësime të ligjit bazik).

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i mungesës së zhvillimit të procedurave të rekrutimit për plotësim të pozitave të rregullta si dhe mosmarrjes së veprimeve për rishikim të vendimeve dhe harmonizimit të tyre me kornizën e re ligjore.

**Ndikimi**

Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre për një kohë më të gjatë se afati i paraparë ligjor rrezikon që pozitat e ndryshme të mbahen nga zyrtar që nuk i përmbushin kriteret e kërkuara për pozitat adekuate.

**Rekomandimi B3**      Ministrja duhet të sigurojë se po ndërmerren të gjitha veprimet ligjore për plotësimin e pozitave të lira të punës dhe të evitohë mbajtjen e pozitave të rregullta me ushtrues detyre përtej afatit të lejuar ligjor.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,623,834€, prej tyre në vitin 2025 ishin shpenzuar 1,318,253€. Shpenzimet në këtë kategori kryesisht kanë të bëjnë me pagesa të kryera nga kontratat për investime në parqet industriale, renovime të objekteve dhe ekzekutim të vendimeve gjyqësore.

#### Çështja A3 - Mos përdorimi i sistemit e-prokurimi për modulën e kontratave

**Gjetja** Sipas Rregullores nr. 001/2022 të KRPP, konkretisht nenit 70.1 dhe paragrafit 70.24.f, administrimi i kontratave duhet të realizohet përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi). Ky paragraf përcakton se Menaxheri i Kontratës është i obliguar të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mirëmbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhimin e kontratës në sistemin e prokurimit elektronik.

Gjatë testimit të procedurave të prokurimit, verifikuam që procesi i menaxhimit dhe implementimit të kontratave në MINT nuk është zhvilluar përmes moduleve përkatëse të platformës elektronike të prokurimit publik, siç kërkohet me rregulloren në fuqi.

Kjo vjen kryesisht si rezultat i anashkalimit të detyrimeve ligjore, si dhe mungesës së njohurive dhe trajnimeve të mjaftueshme lidhur me përdorimin e moduleve elektronike për menaxhimin dhe vlerësimin e kontratave.

**Ndikimi** Moszhvillimi i proceseve përmes platformës elektronike e bën menaxhimin e kontratave më pak transparent si dhe e pamundëson që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

**Rekomandimi A3** Ministrja duhet të sigurojë që menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve të realizohet përmes platformës e-prokurimi, në përputhje me kërkesat ligjore.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 12,406,843€, e pasurive jokapitale është 116,639€, si dhe e stoqeve 3,790€.

### Çështja B4 - Mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë

#### Gjetja

Neni 19.4 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare, përcakton se çdo fund vit duhet të bëhet inventarizimi, nga komisioni për inventarizim i cili është përgjegjës për: Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që janë në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore, verifikimi fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jo financiare, krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, dhe hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare.

Komisioni i inventarizimit kishte bërë inventarizimn e pasurisë për vitin 2025, ku kishte përpiluar Raportin gjithëpërfshirës të pasurisë jo financiare, mirëpo më tej nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël. Lidhur me këtë çështje është rekomanduar edhe në vitet paraprake por ende nuk është arritur të zbatohet ky proces sipas kërkesave të rregullores së aplikueshme.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive nga komisionet e inventarizimit të pasurive dhe mos kordinimit në mes të departamenteve përkatëse të MINT për evidentimin final të pasurisë së Ministrisë.

#### Ndikimi

Mungesa e harmonizimit të pasurive pamundëson krahasimin e rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive, prandaj vlera e pasurive në PFV mund të mos jetë e saktë.

#### Rekomandimi B4

Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka njohuritë dhe informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë, si dhe pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

#### Çështja 1

#### **Pasaktësi në prezantimin e të dhënave në PFV.**

#### Gjetja

Në PFV të MINT për vitin 2025 janë identifikuar disa pasaktësi në prezantimin e të dhënave në Pasqyrat Financiare Vjetore, të cilat i kemi shpalosur më poshtë:

- Te neni 16, Raporti për të arkëtueshmet - Gjendja e llogarive të arkëtueshme, përkatësisht bilancet për vitet paraprahe 2024 dhe 2023 ishin paraqitur gabimisht, ku për vitin 2024 kishte nënvlerësim të gjendjes së llogarive të arkëtueshme për 316,269€ si dhe për vitin 2023 nënvlerësim për 298,966€;
- Te neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit - përkatësisht te Hyrja e Parasë së Gatshme, nuk ishin prezantuar "Të hyrat nga viti i kaluar, në vlerë 20,255€; dhe
- Vlera e Granteve të përcaktuara të donatorëve prej 500,000€ e prezantuar në Nenin 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit, nuk ishte në përputhje me vlerën e shpalosur tek Shënimi 11, rrjedhimisht tek shënimi vlera e granteve ishte e mbivlerësuar për 17,000€.

#### Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për t'i korigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

#### Rezultati

Menaxhmenti kishte marrë veprime korigjuuese për paraqitje të drejtë dhe të saktë të PFV gjatë procesit të auditimit dhe kishte bërë korigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PVF e vitit vijues atëherë çështja do të rezultoj me rekomandim në raportin e auditimit.

### 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>28,570,046</b>	<b>25,772,126</b>	<b>16,653,994</b>	<b>12,132,996</b>	<b>33,912,794</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	28,570,046	25,255,401	16,166,748	12,130,719	27,434,081
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	6,478,712
Donacionet e jashtme	0	516,724	487,245	2,277	0

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 2,797,920€. Ky ndryshim është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore, të hyrave të pranuar nga fondet e donatorëve si dhe shkurtimeve buxhetore me vendime qeveritare për kursime.

Në vitin 2025 MINT ka shpenzuar 65% të buxhetit final ose 16,653,994€, me një rritje prej 14% në krahasim me vitin 2024. Megjithatë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel jo të kënaqshëm.

Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>28,570,046</b>	<b>25,772,126</b>	<b>16,653,994</b>	<b>12,132,996</b>	<b>33,912,794</b>
Pagat dhe mëditjet	2,686,005	2,576,190	2,571,449	2,258,481	2,120,076
Mallrat dhe shërbimet	7,259,761	5,112,114	2,625,242	1,651,971	10,414,455
Komunalitë	158,280	68,280	48,194	75,969	98,041
Subvencionet dhe transferet	8,246,000	10,445,542	10,248,380	6,497,071	18,754,543
Investimet Kapitale	10,220,000	7,570,000	1,160,729	1,649,504	2,525,678

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 109,815€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimit të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë 85,672€ (për rritje të koeficientit për 0.5 njësi) si dhe vendimit për kursime buxhetore në vlerë 195,487€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 100%;


Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,147,647€. Zvogëlimi ishte bërë përmes vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore në vlerë 2,164,372€ ndërsa nga donacionet kishte rritje të buxhetit fillestar për 16,725€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 51%. Niveli i ulët i realizimit ishte si pasojë e dështimit të procesit të tenderimit, për kontratën e furnizimit me grurë për nevoja të rezervës shtetërore.

Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 90,000€ përmes vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 71%;

Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,199,542€. Kjo rritje ishte rezultat i transferit të mjeteve në vlerë 2,300,000€ nga kategoria e investimeve kapitale, për përkrahjen financiare të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) për blerjen e makinerive të avancuara prodhuese dhe përpunuese; rritje e buxhetit si rezultat i të hyrave të pranuar nga donatorët në vlerë 500,000€ si dhe zvogëlim i buxhetit në vlerë 600,458€ me vendim qeveritar për kursime. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 98%.

Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,650,000€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendime të Qeverisë për kursime buxhetore në vlerë 350,000€ si dhe mjete në vlerë 2,300,000€ ishin transferuar në kategorinë subvencione dhe transfere. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte vetëm 15%. Kjo performance e dobët buxhetore është kryesisht rezultat i dështimeve dhe vonesave në kontraktim të projekteve të planifikuara, si rezultat i ankesave gjatë proceseve të tenderimit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga MINT në vitin 2025 ishin në vlerë prej 2,192,704€. Ato kanë të bëjnë me regjistrimin e pengut, pronësisë industriale, të hyrat nga licenca për shërbime profesionale, licenca për importimin e naftës, licencat për importimin e duhanit, të hyrat nga qiraja dhe të hyrat tjera.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>3,117,206</b>	<b>3,117,206</b>	<b>2,192,704</b>	<b>2,059,878</b>	<b>2,105,854</b>
Të hyrat jo tatimore	3,117,206	3,117,206	2,172,449	2,059,878	2,105,854
Të hyrat tjera	0	0	20,255		


## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të MINT ka rezultuar me tetë (8) rekomandime. MINT ka përgatitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, tre (3) rekomandime janë zbatuar, një (1) ishte në proces, dhe katër (4) nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një kordinim më efektiv në mes drejtorive në raportimin e faturave të papaguara me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve të papaguara.	Edhe këtë vit kemi identifikuar obligime të pa raportuara në PFV.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Ministrja, duhet të siguroj kontrole efektive dhe një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen pa gabime në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.	Edhe këtë vit kemi konstatuar që regjistri i detyrimeve kontigjente është i mbivlerësuar.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të siguroj se po ndërmerrin të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave me ushtrues detyre me pozita të rregullta.	Edhe këtë vit kemi identifikuar raste të mbajtjes së pozitave të punës me ushtrues detyre përtej afatit të lejuar ligjor.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të siguroj monitorim efektiv për të parandaluar të gjitha anashkalimet e kritereve të përcaktuara me marrëveshjet e nënshkruara apo udhëzuesit e secilës thirrje përkatëse për subvencionim. Po ashtu, në rastet e shkeljeve të konstatuara duhet të merren të gjitha veprimet e parapara ligjore.	Në thirrjet për subvencionim të vitit 2025, entiteti kishte aplikuar ndryshimet në kriteret e thirrjes publike (Udhëzuesi për aplikim), rrjedhimisht nuk kemi identifikuar devijime të tilla këtë vit.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Ministrja duhet të sigurojë që për çdo pagesë ndaj personave jorezidentë të aplikohet mbajtja e tatimit në burim prej 5% siç e parasheh ligji. Po ashtu, duhet të merren veprime konkrete që në pagesën e mbetur për kontratën e lartëcekur të aplikohet tatimi në burim për tërësinë e kontratës.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit. Sa i përket rastit të identifikuar në vitin paraprak, në faturën e fundit ishte aplikuar zbritja e tatimit për tërë kontratën.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë që për projektet të cilat janë të përfunduara dhe janë bërë pranimet teknike, të bëhen rregullimet e nevojshme në regjistrat e pasurisë ashtu që vlera e tyre në regjistra të pasqyrohet sipas rregullores.	Ministria kishte ndërmarr disa masa dhe një numër i projekteve të përfunduara ishte dërguar për bartje tek komunitetet përgjegjëse dhe ish-in mbyllur llogaritë e investimeve në vijim në regjistrin e pasurive të ministrisë. Megjithatë identifikua edhe disa projekte që nuk është bartur ende pronësia tek komunitetet.	Pjesërisht i zbatuar

7.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka njohuritë dhe informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë, si dhe pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV.	Edhe këtë vit nuk është bërë harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrin e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Auditimi i Brendshëm	Ministrja duhet të sigurojë që Komiteti i Auditimit të mbaj takime të rregullta në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja efektive ndaj NjAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.	Gjatë vitit 2025, komiteti i auditimit ishte funksional.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Fjolla Bakalli Sadiku, Udhëheqëse e ekipit



Flora Berisha, Anëtare e ekipit



Veton Misiri, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË, TREGTISË DHE INOVACIONIT			
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA, TRGOVINE I INOVACIJA			
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP, TRADE AND INNOVATION			
№ Shk. Org. Org. Number	02	№ Prlet. Prlet. Number	2096
№ Hapjeve Shpjesorëve Pages		Data Date	08.05.2026
PRISHTINE/KA			

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija - Ministry of Industry,  
Entrepreneurship, Trade and Innovation

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025  
dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, për vitin 2025
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Artan Demoll

U.d. Sekretari Përgjithshëm

Data: 8 Maj 2026



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.